



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
BASHKIA SKRAPAR

Data 27.06.2016

**Degjesa e Katert Publike. Hartimit I Planit Te Pergjithshem Vendor per Bashkine Skrapar.**

**Tema: Vleresimi Strategjik Mjedisor, Plani i Zhvillimit të Territorit dhe Rregullorja e Planit.**

Sot me date 27.06.2016, ora 10:00 ne nje nga sallat e Kinemase se qytetit te Corovodes u mbajt Degjesa e Katert Publike rreth PPV te Bashkise Skrapar.

Fjalën e hapjes se ketij takimi e mori perfaqesuesi I firmes GAIA Znj.Diana Bardhi e cila falenderoi te pranishmit per prezencen e tyre dhe vijoi me prezantimin e materialit Vleresimi Strategjik Mjedisor. Ne prezantimin e saj I dha nje theksim ndikimeve mjedisore të propozimeve të Planit dhe rolin e faktoreve qe ndikojne ne mjedis.

**Boshtet e Prioritetit, në përputhje me PPV,të cilat pritet të ndikojnë në terren**

1. Mbrojtje dhe vleresim I qendrueshem I hapësirave te kultivuara ne sektorin bujqesor.
2. Mbrojtje dhe vleresim I qendrueshem I ekosistemeve pyjore.
3. Mbrojtje dhe administrimi I qendrueshem I burimeve ujore.
4. Mbrojtje dhe forcim I bioshumellojshmerise.
5. Trajnim mjedisor I shoqerise locale.
6. Rimekembje,modernizim dhe shtrirje e rrjeteve te perfitimit te perbashket dhe permiresim I infrastrukturave teknike mjedisore.
7. Shfrytezim I Burimeve te rinovueshme te energjise.
8. Modernizim dhe forcim I prodhimit paresor.

**Boshtet e Prioritetit, në përputhje me PPV, të cilat pritet të ndikojnë në ajër**

1. Rimekembje,modernizim dhe shtrirje e rrjeteve te perfitimit te perbashket dhe permiresim I infrastrukturave teknike mjedisore.
2. Permiresim I levizshmerise dhe modernizimit te infrastrukturave te transportit.
3. Qeverisje elektronike dhe permiresim I infrastrukturave elektronike.
4. Shfrytezim I Burimeve te rinovueshme te energjise.

**Boshtet e Prioritetit, në përputhje me PPV, të cilat pritet të ndikojnë në faktorët klimaterikë**

1. Permiresim I levizshmerise dhe modernizimit te infrastrukturave te transportit.



## 2. Shfrytezim I Burimeve te rinovueshme te energjise.

### **Boshtet e Prioritetit, në përputhje me PPV, të cilat pritet të ndikojnë në ujërat**

1. Mbrojtje dhe vleresim I qendrueshem I hapësirave te kultivuara ne sektorin bujqesor.
2. Mbrojtje dhe administrimi I qendrueshem I burimeve ujore.
3. Mbrojtje dhe forcim I bioshumellojshmerise.
4. Trajnim mjedisor I shoqerise locale.
5. Rimekembje,modernizim dhe shtrirje e rrjeteve te perfitimit te perbashket dhe permiresim I infrastrukturave teknike mjedisore.
6. Forcim I konceptit te fqinjesisë dhe sigurim I kohezionit dhe solidariteti social te banoreve te Bashkise,me pjesmarrje active ne konsultimet per aktivitetet zhvillimore.
7. Modernizim dhe forcim I prodhimit paresor.
8. Modernizim dhe forcim I prodhimit dytesor.
9. Modernizim dhe forcim I sektorit tercar,duke theksuar format alternative te turizmit.
10. Shfrytezim I Burimeve te Rinovueshme te Energjise.

### **Boshtet e Prioritetit, në përputhje me PPV, të cilët pritet të ndikojnë mbi peisazhin**

1. Modernizim dhe forcim I prodhimit paresor.
2. Modernizim dhe forcim I sektorit tercar,duke theksuar format alternative te turizmit.
3. Inkuadrim I zonave te mbrojtura natyrore ne rrjetet kombetare,europiane dhe nderkombetare te mbrojtjes per sigurimin e mbrojtjes se tyre dhe mbrojtjes se habitateve te tyre.
4. Mbrojtje dhe vleresim I qendrueshem I hapësirave te kultivuara ne sektorin bujqesor.
5. Mbrojtje dhe vleresim I qendrueshem I ekosistemeve pyjore.
6. Mbrojtje dhe administrimi I qendrueshem I burimeve ujore.

Konkluzioni i Studimit të Vlerësimit Strategjik të Ndikimeve në Mjedis është se ndikimet negative janë të kufizuara në faktorë të veçantë të mjedisit (tokës, ujit, biodiversitetit, mbeturinave, mjedisit akustike / zhurmave dhe peizazhit), ndërsa ndikimet pozitive të Projektit të propozuar janë të rëndësishme dhe kanë të bëjnë me të gjithë faktorët e mjedisit.

Pas fjalës përmblyese te znj.Djana Bardhi per **Vleresimin Strategjik Mjedisor**, fjalen e mori Z.Elton Toska perfaqesues I studios GAIA. Pas falenderimeve te bera Z.Toska,nisi me prezantimin e fazes se Trete te Hartimit te Planit te Pergjithshem Vendore te Bashkise Skrapar. me prezantimin permbledhes **"Plani I Zhvillimit te Territorit dhe rregullorja e Planit"**.

Duke bere nje permbledhje Fazes se I-re dhe II-te:

- Analiza territoriale.
- Strategjia territorial.
- Objektivat strategjike.
- Boshtet prioritare.
- Projektet specifike.

Fjala e tij vijoi me permbajtjen e fazes se III-te:

.Parashikimi i popullsisë dhe Shpërndarja e synuar në Bashkinë për vitin 2030

- Përcaktimi i zonave urbane, zonave ekonomike dhe zonave të mbrojtura
- Ndarje e re e territorit sipas 5 Sistemeve Territoriale
- Ndarja e territorit në zona dhe njësi
- Ndarja e kategorive themelore dhe nënkategorive të përdorimit të tokës për çdo njësi
- Përcaktimi i Rregullores Vendore të Ndërtimit
- Rregullorja e Tipologjive të Veçanta, Rregullorjet sipas parcelës dhe nëndarjeve
- Zonat për hartimin PDV dhe për prioritetet e zhvillimit
- Plani i strehimit
- Identifikimi dhe pozicionimi i shërbimeve kryesore publike dhe rrjetit infrastrukturor
- Plani i Veprimit

Me fjalen e tij Z.Toska theksoi se Hartimi I Planit te Pergjithshem Vendor per Bashkine Skrapar eshte kombinimi i 5 Sistemeve territorial,te cilat ndihmojne njera-tjetren. Duke vene ne qender qytetin e Çorovodes,Bogoven si qender turistike,Kanionet e Osumit dhe Gradecit si nje perle jo vetem per Skraparin por per te gjithe vendin tone.

Hartimi I zonimit ndikojne elementet natyrore,afersia me lumin,dalja e truallit me rrugen,prezantim me vijen e kuqe dhe vijen e ndertimit,etj. Zona 6.1 me ndertesa te sherbimit te ushtrise parashikohet me masa te caktuara per aplikim per ndertim.Ne material keni te vedosur ne menyre te detajuar per nr e shkollave dhe çerdheve.

Ne perfundim te fjales se tij, Z.Toska theksoi se per realizimin e ketij Plani pjesa me e rendesishme eshte Plani I Veprimit.

Duke ripermendur qe kemi disa projekte te rendesishme qe duhen realizuar :

- Ndertimi I rrjetit te ri te ujesjellesit
- Nderitmi I rrjetit te kanalizimeve
- Ndertimi I landfillit
- Permiresim I rruges Berat-Çorovode.



Vlen per tu permendur se ne kete Degjese publike ishte i pranishem Z. Fatos Nako – Drejtor i Drejtorise Rajonale te Zonave te Mbrojtura, Berat si dhe Perfaqses te Agjensise Rajonale te Mjedisit, Berat, me te cilet pati diskutime e pyetje ,ne lidhje me Rendesine e Zonave te Mbrojtura dhe atyre Turistike si dhe me rrugen per te shkuar te Teqeja ne Kulmak, ( Parku Kombetar I Tomorrit )

Takimi u mbyll me pyetje dhe diskutime nga Perfaqsesit AKPT, Stafit te Bashkise Skrapar, Perfaqsesit e studios GAIA.

**Protokolloi**

Arisa HIDERSHA



**DREJTORIA E PLANIFIKIMIT TE TERRITORIT**

**DREJTORI**

**Bledar METHOXHA**

